

VENDIM
Nr. 798/3, datë 8.6.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në bazë të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

VENDOSA:

1. Ndërprerjen e delegimit të kompetencave që më jep ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktuara në nenet 8, pika 6, 9, pikat 4 dhe 5 dhe 10 pika 10 të tij, të deleguara zotit Alban Brati, Drejtor i Shërbimit Juridik me vendimin nr. 798 Prot., datë 3.3.2017, për arsye të largimit të tij me shërbim jashtë vendit, për nevoja pune, shërbim i planifikuar kohë më parë.

2. Delegimin e kompetencave që më jep ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të përcaktuara në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara në nenet 8, pika 6, 9 pika 4 dhe 5 dhe pika 10 të tij, zonjës Marsjola Duro Drejtor i Përgjithshëm i Informacionit dhe Dokumentacionit, për arsye të kandidimit tim në organet e rivlerësimit sipas ligjit të sipërpërmendur.

3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 12 qershor 2017 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Albana Shtylla